



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 528 / Prot.
2

Tiranë, më 13.2.2025

Drejtuar: KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Për dijeni: Z. Ilirjan CELIBASHI
KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Lënda: Ankim kundër pikës 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Të nderuar Anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve!

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më datë 11.02.2025, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

Kërkues: Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

Subjekt: Zj. Elisa Spiropali/ Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Palë e interesuar: Kuvendi i Shqipërisë

Objekt: Marrja e hapave të nevojshëm për parandalimin e shtrirjeve të efekteve të projektligjit "Për një shtesë në ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar"

Gjatë shqyrtimi të çështjes administrative të sipërcituar, ndër të tjera u bë me dije që nxitur nga qëllimi i denoncimit të KRIIK, objekt shqyrtimi i këtij procedimi administrativ, KQZ shqyrtoi projektligjet të cilat janë në kalendarin dhe programin e punës së Kuvendit të Shqipërisë për periudhën nga data 20 Janar deri më datën 28 Shkurt 2025.

Sipas Komisionerit, konstatohet se:

"Fusha e veprimt të dy projektligjeve, atij "Për paketën e maleve" dhe projektligjit "Për disa shtesa dhe

ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" prekin politika të rëndësishme fiskale.

Ndryshimet e propozuara kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar, çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë në prag të zgjedhjeve. Ato mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale.

Kufizimet, apo ndalimet e parashikuara në nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor mund të jenë penguese edhe kur vërehet që akti që kërkohet të shqyrtohet, apo miratohet nuk duket se do të përdoret për qëllime politike, apo elektorale. por është vetë ligjëvënsi ai që në këtë pikë e ka vlerësuar që për një kategori aktesh për periudhën 4 (katër) muaj përpara datës së zgjedhjeve ndalimi për miratimin e tyre është i domosdoshëm. Përrjashtimin e ka bërë vetëm për rastet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore."

Për sa më sipër, përmes vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në pikën 2 të tij ka vendosur "T"i rekomandohet Kuvendit të Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin "Për paketën e maleve" dhe Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se pika 2 e vendimi nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është i padrejtë, i pabazuar në ligj dhe bie në kundërshtim me nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor.

ANALIZA LIGJORE

Kuvendi i Shqipërisë nuk është dakort me pikën 2 të vendimi nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sepse për Kuvendin nuk jemi përpara një cenimi të nenit 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor, për arsytet e mëposhtme:

Neni 91 i Kodit Zgjedhor përcakton se:

"Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore."

Vendimi nr. 9, datë 20.12.2020 i Komisionit Rregullator, në nenin 3, pika 3, përcakton:

"Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljen e kamatëvonesave, të globave, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë."

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’” nuk bie ndesh/cenon me nenin 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor.

Së pari duam të sjellim në vëmendjen e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve faktin se propozimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, ‘për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, është një kërkesë e anëtarëve të komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe jo vetëm, që prej vitit 2019 kur u vendos skema aktuale mbajtja e TVSH-së në masën 20% mbi shitjet, ndërkohë që blerjet nga fermerët kryhen me 0%, për shkak se kjo skemë cenon parimin e drejtësisë fiskale dhe krijon një terren që favorizon informalitetin dhe humbjet ekonomike. Shumë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë nga të gjitha krahët, ndër vite e kanë kërkuar këtë skemë, pra nuk jemi aspak në kushtet e një kërkesë elektorale.

Thenë këtë, projektligji synon përmirësimin e kuadrit rregullator për aplikimin e tatimit mbi vlerën e shtuar në sektorin e bujqësisë, duke propozuar një mekanizëm të ri për përlllogaritjen e TVSH-së në rastet kur realizohen transaksione me autofaturim ndërmjet fermerëve dhe personave të tatueshëm. Ai synon të eliminojë disa disbalanca fiskale ekzistuese, të cilat kanë krijuar vështirësi për fermerët dhe bizneset e përfshira në sektorin e tregtimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore (grumbulluesit, përpunuesit dhe tregtarët vendas) duke vënë në rrezik trajtimin e barabartë të subjekteve ekonomike.

Ky projektligj nuk parashikon ulje të taksave në një mënyrë që mund të interpretohet si favorizim elektorale, por synon të krijojë një trajtim të drejtë fiskal për një sektor që është i rëndësishëm për ekonominë kombëtare.

Mbajtja e TVSH-së në masën 20% mbi shitjet, ndërkohë që blerjet nga fermerët kryhen me 0%, cenon parimin e drejtësisë fiskale dhe krijon një terren që favorizon informalitetin dhe humbjet ekonomike. Diskriminimi i produkteve vendase në raport me ato të importuara, të cilat janë të ngarkuara me TVSH në masën 20%, krijon një avantazh të pamërituar për produktet e huaja dhe dëmton konkurrencën për grumbulluesit e produkteve vendase. Ky disbalancë bie në kundërshtim me frymën e legjislacionit që synon mbrojtjen e konkurrencës dhe tregut të brendshëm.

Skema aktuale ka ndikuar negativisht në nivelin e formalitetit të transaksioneve, duke dekurajuar përdorimin e faturave dhe formalizimin ekonomik. Ligji për Procedurat Tatimore përcakton detyrimin për të ndërmarrë masa efektive që synojnë uljen e informalitetit, një objektiv që mund të arrihet vetëm përmes rregullimit të drejtë dhe të qëndrueshëm të skemës së TVSH-së.

Bujqësia dhe blegtoaria përfaqësojnë shtylla kryesore të zhvillimit rural në Shqipëri. Skema aktuale dëmton këto sektorë, duke penguar investimet, duke ulur aftësinë konkurruese dhe duke dekurajuar formalizimin. Përmirësimi i kësaj skeme do të kontribuonte në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm të zonave rurale e përmirësimin e mirëqenies ekonomike të tyre, duke ndikuar drejtpërdrejt në ruajtjen e fuqisë punëtore dhe nxitjen e investimeve.

- Për sa më sipër projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014. “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”:

- Nuk krijon përfitime të drejtpërdrejta për një kategori specifike të popullsisë: Projektligji nuk është një akt që synon favorizimin e ndonjë grupi të caktuar elektorati. Ai trajton një çështje fiskale dhe ekonomike që prek një sektor të tërë të ekonomisë dhe synon krijimin e një ambienti më të drejtë konkurrues.
- Nuk përmban ulje taksash apo përfitime financiare me ndikim electoral: Ky projektligj nuk ndryshon nivelin e taksave për një grup të caktuar zgjedhësish, por sjell një rregullim të përgjithshëm të TVSH-së për sektorin bujqësor. Kjo masë nuk krijon një avantazh të drejtpërdrejtë për një kategori të popullsisë dhe për këtë arsye nuk bie nën kufizimet e nenit 91, pika 4.

Në shtesë të sa më sipër, projektligji nuk përmban dispozita që lidhen me amnistinë fiskale apo faljen e detyrimeve tatimore, elemente që do të mund të përbënin bazë për zbatimin e nenit 91, pika 4. Përkundrazi, projektligji synon formalizimin e sektorit dhe rritjen e transparencës fiskale, gjë që është në përputhje me objektivat e mirëqeverisjes dhe të mbledhjes së të ardhurave publike. Si i tillë, ai nuk mund të konsiderohet si një masë që sjell përfitime të drejtpërdrejta për zgjedhësit apo si një instrument për krijimin e avantazheve elektorale.

Projektligji “Për Paketën e Maleve” nuk bie ndesh/cenon me nenin 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor.

Projektligji “Për Paketën e Maleve” ka për qëllim rregullimin e një çështjeje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe territorial të zonave malore. Ai synon të vendosë një kuadër ligjor për menaxhimin dhe zhvillimin e pasurive të paluajtshme në këto zona, duke krijuar rregulla të qarta për posedimin dhe përdorimin e tyre. Projektligji nuk përfaqëson një akt që krijon përfitime të drejtpërdrejta financiare për qytetarët, por me një reformë administrative që synon të adresojë problematika të mbartura prej kohësh në zonat malore.

Për më tepër, projektligji nuk parashikon shpërndarje të drejtpërdrejtë të fondeve publike për kategori të veçanta të qytetarëve dhe as nuk krijon një skemë favorizimi për ndonjë grup specifik të popullsisë. Përfitimet e mundshme që rrjedhin nga ky projektligj janë të natyrës afatgjatë dhe prekin zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit, jo interesat e një segmenti të caktuar të elektoratit në prag të zgjedhjeve.

Edhe në këtë projektligj duhet evidentuar fakti se ideja e projektligjit paketa e maleve është lancuar prej shumë kohësh tashmë dhe është pjesë e tryezave dhe diskutimeve në mbi 35 shoqëri cilive. Projektligji është postuar në faqen e konsultimit publik më datë 01.10.2024 dhe data e mbylljes së konsultimit ishte data 29.10.2024. Sipas të dhënave në faqen e konsultimit, deri në mbyllje të afatit të konsultimit kishte një numër prej 765 shikimesh, ndaj impakti i saj edhe në rast se do të pranohet se ka është ezauruar shumë përpara afatit kufizues të nenin 91 pika 4 të kodit zgjedhor.

Për sa më sipër projektligji:

- Nuk parashikon shpërndarje të drejtpërdrejtë fondesh apo ndihmash financiare ndaj individëve apo bizneseve, por rregullon procesin administrativ të kalimit të pronësisë dhe zhvillimit të zonave malore. Kjo e dallon atë nga politikat që synojnë përfitime të menjëhershme që mund të përdoren për qëllime elektorale.
- Synon zhvillimin e zonave malore në zhvillim dhe nuk krijon një përfitim të drejtpërdrejtë për një kategori specifike votuesish.
- Përfitimet nga projektligji janë të përgjithshme dhe afatgjata, duke synuar investitorët dhe komunitetet vendore në tërësi dhe jo një grup të caktuar të popullsisë që mund të ndikojë drejtpërdrejt rezultatin e zgjedhjeve.
- Nuk ka një favorizim të një grupi të caktuar të votuesve, pasi ligji vendos kritere të përgjithshme dhe të hapura për të gjithë investitorët dhe poseduesit jopronarë.

Rekomandimi i Komisionerit është i gabuar

Komisioneri në arsyetimin e vendimit pretendon se ndryshimet e propozuara në dy ligjet e sipërcituara dhe analizuara, kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar dhe se çdo veprim në këtë drejtim mund të dëmtojë parimin e barazisë mes aktorëve ekonomikë.

Ky argument është spekulativ dhe nuk bazohet në një analizë konkrete të ndikimit të dy projektligjeve. Nuk ka asnjë provë që këto masa do të krijojnë pabarazi ekonomike në prag të zgjedhjeve, për më tepër kur bëhet fjalë për politika të përgjithshme të zhvillimit ekonomik.

Argumenti se këto projektligje mund të krijojnë perceptimin e përdorimit të mjeteve ligjore për qëllime elektorale është gjithashtu i pasaktë. Perceptimi subjektiv nuk mund të shërbejë si bazë për kufizimin e të drejtave kushtetuese legjislative të Kuvendit.

Ndalimi i miratimit të një projektligji nuk mund të mbështetet vetëm në mundësinë e një perceptimi të gabuar, por duhet të bazohet në fakte konkrete që tregojnë ndikimin e tij real në procesin zgjedhor.

Sa i përket argumentit se ligjvënësi ka vendosur ndalimin e miratimit të akteve të caktuara katër muaj para zgjedhjeve, ky ndalim ka një qëllim të qartë: të shmangë shpërndarjen e fondeve publike me efekte të menjëhershme elektorale. Në rastin konkret, projektligjet nuk përmbajnë elemente të tilla, prandaj ky ndalim nuk mund të zbatohet mekanikisht pa një vlerësim objektiv të secilit rast.

Përfundimisht, Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar se projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’” dhe projektligji “Për Paketën e Maleve”, nuk krijojnë favorizime për një grup specifik të popullsisë dhe nuk përfshin ulje taksash apo përfitime që mund të kenë ndikim electoral pra nuk cenojnë asnjë ndalim të përcaktuar në nenin 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor, si dhe duke vlerësuar se pika 2 e vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përbën një ndërhyrje të pajustificuar në kompetencat e Kuvendit dhe dëmton parimin e ndarjes së pushteteve, vlerëson.

KËRKOJMË:

1. Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
2. Konstatimin se asnjëri prej projektligjeve të sipërpërmendur nuk bie ndesh me nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor;
3. Lejimin e vijimit të procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve në fjalë pa kufizime të pajustificuara.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Genç GJONCAJ

